

Gjirokastra, madhështore dhe e rrallë. E gatshme të të zhvendosë në një tjetër realitet, të cilin nuk mund ta gjesësh askund tjetër. Gjirokastra ju mirëpret! Me rrugët me kalldrëm, banesat e papërsëritshme, ku ndërthuren stili oriental e ai perëndimor, me kështjellën e legjendës së Argjiros, gatimet tradicionale dhe sigurisht, mikpritjen dhe bujarinë e vendasve!

Qyteti- Muze dhe Pasuria Botërore e Trashëgimisë Kulturore ofron dhjetëra destinacione, historike, turistike, kuturore, natyrore e fetare.

QENDRA HISTORIKE E GJIROKASTRËS



Gjirokastra është një qytet që përbën dëshmi unike të një tradite kulturore të jetës së zhvilluar në shek 14-19. Këtu veçohet tipi i shtëpisë së fortifikuar me çati me pllaka guri, në harmoni perfekte me peizazhin shkëmbor të territorit ku ajo ngrihet. Banesat, një tip i veçantë në tipologjinë e banesës shqiptare dhe asaj ballkanase të mesjetës së vonë, luajnë një rol të rëndësishëm në fizionominë e qytetit.

Gjirokastra ka 56 banesa monumente kulture të kategorisë së parë, 502 të kategorisë së dytë dhe shumë komplekse të tjera me vlera historike, arkitektonike dhe kulturore.

Qyteti ruan të paprekur skemën urbanistike, ku çdo shtëpi ka karakteristika të veçanta që lidhen me terrenin mbi të cilin është ndërtuar. Sipas kategorive të monumenteve kulturore, në qytet

dallohen kalaja, pazari, ndërtimet e kultit dhe shtëpitë e banimit. Kalaja, e ndërtuar në shek. 13, përbën zanafillën e qytetit, ndërsa pazari (shek. 17) i vendosur në qendër të qytetit ruan mirë karakteristikat e një pazari tradicional me ndërtesa të njëpasnjëshme të shtruara me kalldrëme gurësh të zinj.

Zona muze përfshin kështjellën, pazarin e qytetit si dhe lagjet: “Pazar i Vjetër”, “Pllakë”, “Hazmurat”, “Teqe”, pjesë të lagjeve “Varosh”, “Meçite”, “Palorto” dhe “Dunavat i Parë” si dhe ansamble të lagjeve “Dunavat i Dytë”, “Manalat” dhe “Cfakë”.


KALAJA E GJIROKASTRËS



Si histori e lidhur me qytetin e Gjirokastrës, përmendet për herë të parë si qytet dhe kështjellë në vitin 1336. Në këto vite, ajo ishte qendra e feudalëve shqiptarë Zenebishë. E megjithatë historianë të ndryshëm mendojnë se ekzistenca e kalasë së gurtë është më e hershme. Sipas tyre, kalaja ka pas dy faza ndërtimi, të cilat lidhen me periudhën para dhe pas Pashallëkut të Janinës dhe fortesave të Ali Pashë Tepelenës. Nga Kalaja mesjetare, ajo e para pushtimit të Ali Pashës, ruhen vetëm pak gjurmë pasi muret janë veshur deri në lartësi nga ndërtimet e reja. Ndërsa, kullat pjesërisht janë rrënuar dhe ripërshtatur.

Aktualisht, kalaja është objekti monumental më i vizituar në Gjirokastrë

PAZARI KARAKTERISTIK I GJIROKASTRËS



Pazari i Gjirokastrës përbën një njësi më vete nga ana urbanistike, gjithnjë duke qenë së bashku me kalanë qendrën e qytetit. Pazari në gjendjen e sotme i përket një rindërtimi tërësor, rreth çerekut të tretë të shek. XIX. Shkak për këtë u bë një zjarr i madh shkatërrues, i cili bëri që ai të rindërtohet tërësisht, duke ruajtur akset e vjetra të rrugëve, por duke i zgjeruar ato. Formulimi arkitektonik thajse uniform i dyqaneve, ndërtimet solide, shpesh trekatëshe dhe përdorimi i gjerë i profileve prej hekuri në formë arkitrarësh, flasin qartë për rindërtimin tërësor të tij.

Në formulimin e tij arkitektonik, Pazari i Gjirokastrës, ka mjaft elementë të përbashkët me banesën gjirokastrite, duke bërë që ai të përfshihet mjaft mirë në tërësinë e qytetit.

Pazari është pikëtakimi i parë i vizitorëve vendas e të huaj me magjinë e Gjirokastrës.

PARKU ARKEOLOGJIK I ANTIGONESË



Me një sipërfaqe prej 92 hektarësh. Shtrihet mbi kodrën e Jermës, pranë fshatit Saraqinishtë të Gjirokastrës. Emri dëshmon se ai duhet të jetë themeluar nga mbreti Pirro rreth vitit 290 p.e.s., për nder të gruas së tij Antigonesë, bijë e mbretit Ptoleme të Egjiptit.

Pllaja mbi të cilën ishte ndërtuar qyteti antik i Antigonesë zotëron të gjithë luginën e Drinos përballë Gjirokastrës. Ndërtimi i qytetit ka qenë realizuar sipas një plani urbanistik, i cili e ndan sipërfaqen prej 45 hektarësh në disa zona. Në Antigone janë zbuluar disa banesa të llojeve të ndryshme, që u përkisnin shtresave tregtare-zejtare të qytetit. Brenda tyre ndodheshin punishte metalesh dhe të përpunimit të lëkurëve. Gjetjet e pasura arkeologjike dëshmojnë për shkallën e lartë të kulturës dhe për mirëqenien e qytetit.

Është një qytet antik, që ende fsheh mjaft pasuri nën tokë.

URA E KORDHOCËS



Sipas historianëve është ndërtuar rreth vitit 1820 dhe në atë kohë ishte nyja kryesore lidhëse për tre qytete, Gjirokastrën, Libohovën dhe Janinën, ndërsa aktualisht njihet si e vetmja nyje lidhëse në luginën e Drinos.

Konstruksioni i gërshetuar me stilin e arkitekturës orientale osmane, tri harqet e mrekullueshme dekorativë dhe shtrimi i plotë me kalldrëm i japin vlera të mëdha historike e arkitekturore, ndërkohë që tanimë është funksionale për kalimin e këmbësorëve dhe automjetëve.

Ura është e gjatë 20 metra dhe e lartë në pikun e saj 7 metra. Pamja e saj nuk ka munguar edhe në disa filma artistikë shqiptarë, të realizur para viteve 1990, si në “Ja vdekja, ja liri”, “Muri i gjallë” dhe “Dasma e Sakos”.